



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



SHALLËBË - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ
SHALLËBË - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ
SHALLËBË - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ - ШАЉЕБЕ
08 12437 31-112-2015
HANI I ELEZIT

Plani i Integruar 2016 - 2018



Hani i Elezit, 2015

Njoftim Editorial:

Plani i Integruar i paraqitur është një punë në progres.

Procesi i përgatitjes së planit të integruar zakonisht përfshin hapat në vijim:

1. Intervistën me Kryetarin e Komunës për të shpjeguar konceptin dhe për të kërkuar aprovimin për zhvillimin e planit.
2. Prezantimin para Bordit të Drejtorëve për të shpjeguar procesin.
3. Intervistat individuale me Drejtorët për të identifikuar prioritetet kyçe të punës.
4. Hartimi i një plani model (në gjuhën Angleze) i bazuar në intervistat e drejtorëve dhe hulumtimet nga planet komunale ekzistuese dhe nga të dhëna të tjera.
5. Përkthimi dhe prezantimi i draft planit për Bordin e Drejtorëve.
6. Editimi nga komuna i draftit të përkthyer.
7. Aprovimi nga Kryetari i Komunës.

Përgatitja e planit të integruar është një proces përsëritës që kërkon korrelacion me planet e tjera dhe me përgatitjen e buxhetit komunal.

Në pajtueshmëri me konceptin e “binjakëzimit” nuk ka qenë roli i projektit të ECSM që të ofrojë një “produkt” të përfunduar për komunat. Synimi ka qenë për të paraqitur një proces të planifikimit të integruar për komunat i cili do të lehtësojë në masë të konsiderueshme dhe përmirësojë zhvillimin strategjik dhe menaxhimin e shërbimeve komunale.

PËRMBAJTJA

1. Fjala hyrëse e Kryetarit të komunës Hani i Elezit , z. Rufki Suma.
2. Profili i Komunës së Hani të Elezit,
3. Vizioni jonë, vlerat tona dhe prioritetet tona,
4. Ekzekutimi, raportimi dhe prioritetet tona,
5. Strategjia Afatmesme e Buxhetit: Pasqyrat kryesore.
6. Menaxhimi i performancës.

1.Fjala hyrëse e Kryetarit

Të nderuar qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit

Si kryetar, jam i lumtur që prezantoj Planin e Parë të Integruar për Komunën e Hanit të Elezit që është një reflektim i dëshirës sonë që t'i mbajmë të gjithë qytetarët, organizatat partner edhe stafin plotësisht të informuar rreth kahjes që Komuna do të marrë në tri vitet e ardhshme. Me Planin e Parë të Integruar për Komunën e Hanit të Elezit synojmë të përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve tanë si një komunë moderne dhe e zhvilluar përmes aktiviteteve ekonomike, arsimore, kulturore dhe rekreative që shpjen drejt një cilësie të mirë të jetës për të gjithë qytetarët.

Progresi i bërë në komunën tonë deri sot është arritur përmes procesit ekzistues të planifikimit dhe me këtë plan të integruar dëshirojmë të ju tregojmë qytetarëve tanë, qeverisë qendrore dhe donatorëve një përmbledhje të përgjithshme të drejtimit që planifikojmë të arrijmë në tri vitet e ardhshme dhe të prioritetëve në të cilat do të fokusohemi që të përmirësojmë jetën e të gjithë qytetarëve tanë. Ky plani i integruar nuk zëvendëson planet tjera por sigurohet që të gjitha përpjekjet tona të jenë të drejtuara drejt arritjes së qëllimeve tona strategjike. Në përgatitjen e këtij plani dhe caktimit të qartë të prioritetëve dhe asaj se si ne shpresojmë t'i arrijmë ato, po demonstrojmë përkushtimin tonë të vazhdueshëm për transparencë dhe llogaridhënie për qëllimet tona.

Ky Plan i Integruar përcakton planet e tona për tri vitet e ardhshme si dëshmi e këtij përkushtimi. Gjithashtu dihet që ka edhe sfida përderisa mundohemi të zhvillojmë këto propozime, duke marrë gjithmonë parasysh gjendjen ekonomike aktuale dhe kapacitetet buxhetore.

Në Planin e Integruar për Komunën janë integruar Planet operationale të drejtorive përkatëse, Plani zhvillimorë komunal, dhe korniza afatmesme e shpenzimeve.

Rrjedhimisht, plani jonë reflekton nevojën për një punë në partneritet dhe dëshirën tonë për të bashkëpunuar në të gjitha nivelet që të sigurohen rezultatet më të mira të mundshme. Sigurisht është thelbësore që komuna të tregojë kapacitetin profesional për të mbështetur këto përpjekje gjithëpërfshirëse në plan dhe është qëllim i yni që të vazhdojmë të zhvillojmë kapacitetin tonë organizativ dhe menaxherial duke implementuar praktikat më të mira në Komunën tonë që të jemi në vijë me standardet evropiane. Kështu që jemi të përkushtuar të mirëmbajmë një standard të lartë të qeverisjes dhe menaxhimit profesional në rrugën tonë përpara. Besojmë që është thelbësore që të vazhdojmë të demonstrojmë, në një mënyrë të hapur dhe transparente, që kemi një administratë stabile dhe që u përgjigjet kërkesave e që do të përmbushë nevojat e shërbimeve të qytetarëve tanë në mënyrë efektive.

Vizioni ynë thelbësor për Komunën e Hanit të Elezit është të promovoj zhvillim ekonomik dhe të zhvilloj mundësitë për investime kapitale, me synimin hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin e sektorit të bujqësisë, përmirësimin e shërbimeve publike, mbrojmë mjedisin tonë duke promovuar vlerat natyror, kulturore dhe historike. Komuna e Hanit të Elezit ka potencialin që të bëhet një qendër atraktive ku të gjithë qytetarët gëzojnë jetë të mirë për veten dhe familjet e tyre. Shpresoj se në vizionin tonë të kemi mbështetje e institucione vendore dhe donatorë ndërkombëtarë. Zhvillimet në realizimin Planit të Integruar për Komunën do të raportojmë në baza vjetore tek Asambleja Komunale dhe qytetarët.

Kryetari i Komunës
Ruftki Suma



2. Profili i Komunës

Vendbanimi i Hanit të Elezit gjindet në një pozitë ideale gjeografike pasi që prek rrugën kryesore nga Prishtina për në Shkup. Është pikë kufitare, ndërkaq që njëkohësisht edhe industria është mjaft e zhvilluar dhe e njohur jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë vendit. Në pjesën jugore të Hanit të Elezit gjendet pika kufitare që ndan territorin e Kosovës nga ai i Maqedonisë.

Kjo paraqet një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën, pasi që shumica e transportit të mallrave, realizohet përmes kësaj pike kufitare.

Shumica e banorëve nga fshatrat për rreth kanë lidhje të forta me Hanin e Elezit, pasi që mundësitë për punësim eventual kryesisht gjinden në pjesën jug lindore të qytetit, ku është e vendosur zona industriale e qytetit.

Rajoni i Hanit të Elezit ka formën e një modeli të zgjatur veriperëndim-juglindje, me gjatësi rreth 6.5km dhe një sipërfaqe prej 82.95km² ose 8294.37.53ha (gjithsej 0,77% të territorit të Kosovës), duke përfshirë edhe fshatrat për rreth.

Komuna përbëhet nga dhjetë vendbanime rurale dhe qyteti i Hanit të Elezit. Vendbanimet rurale janë të shtrira në të dy anët e qytetit. Vendbanimet Pustenik, Seçishtë, Krivenik, Gorancë dhe Rezhancë shtrihen brenda Maleve të Sharrit në perëndim, ndërsa fshatrat Paldenicë, Dimcë, Dërmjak, Neçavcë dhe Vërtomicë i perkasin Maleve të Karadakut në lindje.

Qyteti tanimë ka infrastrukturë relativisht të mirë përmes lidhjeve rrugore me fshatrat përreth. Siç u theksua tanimë, Komuna e Hanit të Elezit i ka gjithsej 11 zona kadastrale, dy prej të cilave kanë qenë të shpopulluara që nga viti 1999. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të realizuar në vitin 2011, popullata e përgjithshme në Komunën e Hanit të Elezit është 9,403 banorë, të cilët kryesisht janë shqiptarë të Kosovës. Ka 42 boshnjakë të Kosovës që gjithashtu jetojnë aty. Që nga themelimi i fabrikës së çimentos në vitin 1936, numri i popullsisë në Hanin e Elezit është rritur vazhdimisht.

Nga aspekti etnik dhe fetar, struktura e popullsisë është mjaft homogjene meqenëse nga 9,403 banorë, vetëm 42 janë boshnjak, ndërsa të tjerët janë shqiptarë, ndërkaq që 100% e popullsisë është e fesë myslimane.

Bujqësia padyshim luan një rol të rëndësishëm për çdo komunë, sidomos për ato si ajo e Hanit të Elezit që përfshin edhe dhjetë vendbanime rurale. Me këtë rast, duhet pasur parasysh se çdo vend i ka specifikat e veta të tokës, terrenit, klimës dhe mënyrës së prodhimit bujqësor.


Hani i Elezit ka burime të mjaftueshme të drurit dhe ujit si dhe një sasi të konsiderueshme të tokës bujqësore.

Administrata Komunale udhëhiqet nga Kryetari i pavarur dhe nga 8 drejtori. Administrata komunale ka gjithsejtë 222 punonjës duke përfshirë stafin e arsimit, shëndetësin dhe mirëqenie sociale. Buxheti komunal për vitin 2015 ka qenë në shumë prej 2,196,086 euro.

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria e Shëndetësis dhe Mirëqenies Sociale
4. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
5. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Ambientit
6. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë
7. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
8. Drejtoria e Bujqësis, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kuvendi i Komunës përbëhet nga 15 anëtarë të zgjedhur që përfaqësojnë partitë politike, më poshtë kemi të bashkangjitur shpërndarjen e vendeve partiake në formë tabelare dhe grafikën.

AAK	VV	PDK	LDK
4	4	4	3



3.VIZIONI, VLERAT DHE PRIORITETET E KOMUNËS

Ky plan i integruar tregon detaje rreth mënyrës sesi ne synojmë të promovojmë mirëqenien sociale, ekonomike dhe mjedisore të Hanit të Elezit. Vizioni për Komunën e Hanit të Elezit është:

"Hani i Elezit - Komunë portë, urë në mes dy shteteve Kosovë- Maqedoni me shërbime të zhvilluara të administratës, zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në burime natyrore dhe industriale, zhvillim të përparuar të bujqësisë, zhvillim i balancuar me një vëmendje më të madhe ndaj mbrojtjes së mjedisit, me infrastrukturë të zhvilluar fizike, sociale dhe kulturore dhe jetë të shëndetshme për të gjithë".

Ne e dimë që për të arritur këtë duhet të punojmë në partneritet me një sërë organizatash në aspektin afatgjatë. Kryetari dhe Drejtorët janë takuar me përfaqësues të akredituar të ambasadave dhe donatorët që punojnë në Kosovë që të promovojmë Hanin e Elezit me institucione si BE, OSBE, Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Qëllimi i këtyre takimeve është të zhvillojë bashkëpunimin dhe promovimin e investimeve dhe zhvillimit në Komunë.

Përfaqësuesit e Hanit të Elezit gjithashtu punojnë ngushtë me një sërë organizatash publike veçanërisht me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë Kryesore, Odën Ekonomike, USAID-in, UN-HABITAT, DEMOS, CDF, IOM, Fundacioni Kosov Luxemburg, bizneset kryesore të Sektorit Privat, Organizatat joqeveritare (LAB) dhe organizata tjera. Sa i përket sigurisë publike gjatë vitit ka takime të rregullta me përfaqësues të lartë të KFOR-it, PK-së, FSK-së dhe EULEX-it.

Ky plan është një element thelbësor i rrugës së komunës për të ngritur vazhdimisht standarde të performancës dhe do të ndihmojë të sigurojë rezultate më të mira për njerëzit e saj. Kjo formon bazën në të cilën të gjitha performancat dhe arritjet do të mbikëqyren dhe raportohen tek qytetarët.

Në Komunën e Hanit të Elezit kemi vlera të përbashkëta bazë që formësojnë se si bashkëpunojmë me qytetarët dhe organizatat partnere. Gjatë gjithë kohës synojmë që gjithçka që bëjmë dhe shërbimet që i ofrojmë të jenë të duhura për njerëzit që kanë nevojë për to.

Ne jemi të përkushtuar që:

- ❖ të jemi të hapur dhe të ndershëm;
- ❖ të çmujmë shumëllajshmërinë dhe të promovojmë barazinë;
- ❖ të pranojmë përgjegjësinë me vullnet;
- ❖ të tregojmë respekt, përkushtim dhe besnikëri;
- ❖ të punojmë në partneritet;

Ne besojmë që është e rëndësishme të ju tregojmë se çfarë do të bëjmë në mënyrë që ju të mund të kërkonti llogari prej nesh.

Pas konsultimeve publike, do të organizojmë aktivitetet tona në komunë në katër prioritete strategjike që të arrijmë vizionin tonë. Tri nga prioritetet tona janë të fokusuara nga jashtë në arritjen e vizionit dhe e katërta është e brendshme që i kontribuon zhvillimit të shërbimeve më të mira komunale për qytetarët tanë. Adresimi i këtyre katër prioriteteve strategjike do të mbështeten nga investimet kapitale dhe shpenzimet e të hyrave, progresi i të cilave do të mbikëqyret dhe raportohet tek qytetarët dhe Kuvendi së paku dy herë në vit.

Detajet rreth asaj sesi janë ndarë këto prioritete mund t'i gjeni më poshtë:

- Forcimi i ekonomisë komunale duke u dhënë mundësi të gjithëve ;
- Përmirësimi i jetës dhe mirëqenies së qytetarëve ;
- Përmirësimi i mjedisit në mënyrë të qëndrueshme ;
- Të sigurohemi të kemi një organizatë komunale efektive që të përmbushë prioritetet e mësipërme .

Këto katër prioritete do të adresohen në mënyrë energjike në një periudhë tri-vjeçare dhe çdo vit do të raportojmë progresin tonë kundrejt planit tek të gjithë aktorët.

4. Ekzekutimi dhe raportimi prioritetet tona,

Komiza e planit është e detajuar më poshtë.

Vizioni	"Hani i Elezit - Komunë portë, urë në mes dy shteteve Kosovë- Maqedon me shërbime të zhvilluara të administratës; zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në burime natyrore dhe industrial , zhvillim të përparuar të bujqësisë, zhvillim i balancuar me një vëmendje më të madhe ndaj mbrojtjes së mjedisit; me infrastrukturë të zhvilluar fizike, sociale dhe kulturore dhe jetë të shëndetshme për të gjithë"				
Prioritetet	▼		▼		▼
	Forcimi i ekonomisë komunale		Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve		Përmirësimi i mjedisit në mënyrë të qëndrueshme
Rezultatet	▼		▼		▼
	1. Përmirësimi i standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjeve; 2. Krijimi i mjedisit të qëndrueshëm për ndërmarrësi 3. Mbështetje e drejtpërdrejtë për sektorët e bujqësisë dhe blegtorisë ;		1. Asistencë Sociale për familjet në nevojë dhe ofrimi i shërbimeve populatës në gjendje të nevojës sociale ; 2. Përmirësim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe shtim stafit (QKMF) shëndetësor ;		1.Përmirësime në infrastrukturë rrugore si dhe sistemit ujit dhe kanalizimit ; 2.Përmirësimi i standardeve mjedisore ; 3. Shtimi i më shumë hapësirave të gjelbërta në qytet ;
	▲		▲		▲
Administrata Lokale Efektive					
Mbështetja	1.Standard i mirë i ofrimit të shërbimeve	2.Stabilitet Financiar	3.Bashkëpunim të mirë me komunitetin	4.Staf profesional dhe të trajnuar mirë	5.Qeverisje të mirë

PRIORITETI 1. A - FORCIMI I EKONOMISË LOKALE

Përmirësimi i standardeve të arsimit për tre vite (2016-2018)			
Prioritetet	Treguesit	Synimet	Masat/Iniciativat
Zhvillimi i arsimit në kushte bashkëkohore dhe të sigurta	<p>Përmirësime funksionale në rrjetin shkollor</p> <p>Cilësia e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes</p> <p>Zvogëlimi i nr. të nx. në klasë sipas standardeve për formimin e paraleles</p> <p>Pasurohen bibliotekat me libra shkollore</p> <p>Zvogëlimi i numrit të nxënësve që braktisin shkollën</p>	Sigurimin e kushteve për mësim bashkëkohor dhe kualitativ	Krijimin e mundësive në shkolla për përmirësimin dhe zhvillimin e aftësive tek nxënësit për zgjidhjen e problemeve dhe krijimin zgjidhjeve të qëndrueshme
Rindërtimin (rinovimin) e infrastrukturës shkollore dhe pajisjen e kabineteve me mjete mësimore (kimisë, biologjisë, tik-ut, artit, muzikës) etj.	<p>Numri i shkollave dhe objekteve sportive të rinovuara</p> <p>Numri i kabineteve të rinovuara</p> <p>Numri i inventarëve, mjeteve dhe veglave ndihmëse të reja (nëpër shkolla)</p>	Inventari i vjetërsuar i ndërruar sipas nevojës së shkollave	<p>Rindërtimin dhe zgjerimin e infrastrukturës shkollore sipas standardeve për efikasitetin energjetik duke i përfshirë dhe objektet sportive</p> <p>Modernizimin e inventarit shkollor në shkollat fillore dhe të mesme</p> <p>Modernizimin e kabineteve me pajisje dhe vegla ndihmëse mësimore</p>
Rritja e mjeteve buxhetore komunale të dedikuara për arsim	Lartësia e zërit për arsim në buxhetin komunal	Rritje e buxhetit komunal për arsim	<p>Rritja e investimeve në arsim nga buxheti komunal & donator</p> <p>Bashkëpunimi me me qeverinë (MASHT-i) për rritjen e mjeteve për arsimim</p>

Emërtimi i aktiviteteve	KOHA E REALIZIMIT			Implementues
	2016	2017	2018	
Identifikimi , ruajtja, mbrojtja dhe prezantimi i Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Hanit të Elezit	√	√	√	DKA/ MKRS
Angazhimi për themelimin e klubeve sportive	√	√	√	DKA
Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive	√	√	√	DKA
Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla	√	√	√	DKA
Hartimi i programeve, plan programeve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimitdhënësve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike	√	√	√	DKA
Identifikimi i shkollave që kane nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës me prioritet nga Plani Zhvillimor i Shkollës	√	√	√	DKA
Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve	√	√	√	DKA
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioritetëve të shkollave me nevoja me të theksuara	√	√	√	DKA

REZULTATI 1B			
Krijimi i mjedisit të qëndrueshëm për ndërmarrësi			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Hapja e zyrës informuese për biznese.	Ky projekt kishte me ndiku për të kontrolluar zhvillimin në një mënyrë të qëndrueshme, duke promovuar interesat e përbashkëta të banorëve në fushat e zhvillimit social, mjedisit dhe shfrytëzimit të tokës, zhvillimit ekonomik dhe të infrastrukturës brenda territorit të Hanit të Elezit.	2,000 €	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Fundacioi Kosovë Luxembourg
Dizajnimi i "Informatorit për biznes" udhëzues biznesi (boroshurë)	Kjo broshurë duhet krijuar për të dhënë sa më shumë informata që është e mundur rreth biznesit në Kosovë dhe jep udhëzime për procedurat të cilat do të ju ndihmojnë ju për të arritur sukses të biznesit tuaj.	3,000€	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Fundacioi Kosovë Luxembourg
Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2020.	Komuna e Hanit të Elezit nuk ka strategji zhvillimore, andaj këtë e kemi prioritet. Me këtë strategji synojmë planifikimin e hapave për një zhvillim të qëndrueshëm e cila krijon mundësi të reja për punësim, investime, qasje ndër institucionale dhe bashkëveprim me organizatat/OJQ-ët, bizneset dhe grupet e tjera të interesit.	Nuk nevojitet kosto.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

REZULTATI 1C Mbështetje e drejtpërdrejt në sektorin e bujqësis dhe blektorisë 2016-2018			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Subvencione 2016-2018	Personi Përgjegjës
Subvencionimi i fermerëve për mbjellje të grurit, misrit, patateve, pasulit.	Rritja e nivelit aktual nga 80ha në 150 ha grurë Rritja e nivelit nga 5ha në 15ha misër Rritja e nivlit nga 2ha në 6ha patate.	Kostoja : 20,000€ buxheti komunal	Drejtoria e Bujqësi ,Pylltaris dhe ZHvillimit Rural
Subvencionimi i fermerëve për mbjellje të pemëve të imëta (mjedera,dredhëza)	Rritja e nivelit të mjedrës nga 2.65ha ne 10ha. Rritja e nivelit të dredhëzës nga 1.20ha në 3ha.	Kostoja : 5,000€ buxheti komunal	Drejtoria e BPZHR-se OIQ -LABI OIQ – IKC dhe FKL
Subvencionimi i fermerëve për mbjellje të perimeve në hortikultur (serra familjare dhe bizneseve te vogela)	Rritja e nivelit të serrave familjare nga 74a në 1.5ha Serra komerciale nga 35a në 70a.	Kostoja : 5,000€ buxheti komunal	Drejtoria e BPZHR-së OIQ -LABI OIQ – IKC dhe FKL
Subvencionimi i fermerëve për mbjellje të vreshtave	Rritja e nivelit aktuar nga 40 a në 2 ha	Kostoja : 3,000€ buxheti komunal	Drejtoria e BPZHR-së OIQ -LABI OIQ – IKC dhe OIQ tjera
Pyllëzimi i zonave të zhveshura dhe rrallime paratregtare.	Rritja e sipërfaqës së pyllëzuar për 40ha	Kostoja:15,000€	MBPZHR APK Komuna dhe Donatorë
Zhvillimi i zonave me potenciale zhvillimore turistike	Shikimi i mundësisë për një qndër rekreative pë pushim dhe turizëm	Kostoja:20,000€	MBPZHR Komuna dhe Donatorë

Subvencionimi i bletarëve	Rritja e koshereve të bletëve nga 850 koshere në 2,000 koshere	Kostoja: 12,000€	Drejtoria e BPZHR-se OJQ -LABI OJQ – IKC AKL dhe
Subvencionimi në Blegtori	Rritja e numrit të: - lopëve qumështore - deleve qumështore dhe - dhive qumështore	Kostoja: 50,000 €	Drejtoria e BPZHR-se OJQ-te dhe Donatorë

PRIORITETI 2 –PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE

REZULTATI 2A Përmirësimet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Blerja e një autoveture Xhip për QKMF për vizita shtëpiake Hemodializ etj.	Për shkak se QKMF nuk ka një autovetur sidomos për sezonin e dimrit pasi që një pjesë e terrenit është kodrinoromalore.	10.000,00 €	Drejtoria e shëndetsisë dhe mireqenjes
Ndërtimi i katit të dytë të QKMF-së	Rritet hapsira punuese si dhe ambient i mjaftueshëm për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në kuadër të QKMF-së, implemetohet Mjekësia Familjare	100.000,00 €	DSHMS dhe Donator
Ulja e raportit pacient/doctor pacient/infermier si dhe staf teknik	Ulja e proporcionit Doktor/pacient Infermier/pacient si dhe shtimi i stafit në QKMF.	50.000,00 €	DSHMS dhe Ministria e Financave

REZULTATI 2B Përmirësime në ofrimin e shërbimeve shëndetësore			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Rritja e përqindjes së fëmijëve në klasat 1-9 që pranojnë kontrolla mjekësore	Rritja nga niveli aktual prej 10% në 70% deri në vitin 2018	Nuk nevojitet kosto.	Drejtori në QKMF
Ngritja e cilësisë së shërbimeve në raport me pacientat. Ndërtimi i AMF-së Paldenicë	Për momentin qytetarët i kryejnë shërbimet në QKMF do ta shkarkonte QKMF-në nga numri I madh I pacientave	50.000.00€ Kjo synohet të bëhet deri në 2018	DSHMS dhe Donator i mundshëm

PRIORITETI 3 – PËRMIRËSIMI I MJEDISIT NË MËNYRË TË QËNDRUESHME

REZULTATI 3A Përmirësime në rigjenerimin e infrastrukturës rrugore si dhe sistemit të transportit, ujit dhe kanalizimit			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Shtimi i kapaciteteve të ujit	Përmirësimi i gjedjes egzistuese	30,000€	Drejtorja e Shërbimeve Publike
Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat urbane dhe rurale.	Përmirësimi i jetës së qytetareve me rregullimin e infrastrukturës rrugore.	130,000€	Drejtorja e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonave urbane dhe rurale të Hanit të Elezit	Përmirësimi i jetës së qytetareve me rregullimin e infrastrukturës rrugore.	90,000€	Drejtorja e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

REZULTATI 3B Përmirësimi i standardeve mjedisore			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis	<ul style="list-style-type: none"> -Përpjekjet e përbashkëta brenda komunitetit lokal në zgjidhjen e problemeve mjedisore, -Pjesëmarrja e të gjitha partive të interesuara në realizimin e projekteve në ngritjen e nivelit në ndërgjegjësimin publik, -Ndihmohet komunitetin në aplikimin e standardeve të BE-së në mbrojtjen e mjedisit, -Interesat në mes donatorëve dhe investuesve -Qasje të lehtë në informatat e mjedisit -Mjedis të shëndetshëm, përmirësimi i kushteve lokale për jetesë 	40,000 € (2015)	Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Revitalizimi dhe rikultivimi i pjesëve urbane dhe rurale	Gjelbërimi i qytetit	3,000 €	Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

REZULTATI 3C Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbra në qytet			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese	Parandalimi i ndotjes përmes gjelbërimit	3,000	Drejtoria e Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese	Mirëmbajtja e 300 drunjve dhe pjesëve tjera.	5,000	DUKMM
Aktivitetet mjedisore me rastin e festave ndërkombëtare të mjedisit	Vetëdijësimi i qytetareve për mbrojtjen e mjedisit	500 €	DUKMM
Pastrimi i lumenjve	Pastrim dhe vetëdijësim	20,000 €	DUKMM dhe Donacione

PRIORITY 4- NJË ADMINISTRATË LOKALE EFEKTIVE

REZULTATI 4A Stabilitet financiar dhe vlerën më të mirë			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Përgatitja e buxheteve reale dhe të qëndrueshme vjetore dhe afatmesme dhe në vijë me planet	Kompletimi i Buxheteve Vjetore dhe PAF në vijë me kërkesat statutore	Nuk nevojitet kosto.	ZKA ZKF
Rritja e përqindjes së arkëtimit të taksës në prone	Rritje vjetore	Nuk nevojitet kosto	Drejtoria e Finacave
Rritje të përgjithshme në Të Hyrat Nga subjektet afariste	Rritje vjetore në të hyrat vetanake	Nuk nevojitet kosto.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
Prokurimi i kontratave në vijë me procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr.04/L-042	Zbatimi i kriterëve të përshkruara të prokurimit gjatë tërë periudhës së planit	Nuk nevojitet kosto.	Zyra e Prokurim

REZULTATI 4B Standard të mirë të Ofrimit të Shërbimeve nga një staf profesional			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Implementimi i Skemës së Vlerësimit të Performancës	I tërë stafi do të ketë vlerësime vjetore individuale të performancës	Nuk nevojitet kosto.	Të gjitha drejtorite
Zhvillimi i qasjes së ekpilit të projektit	Të zbatohet Programi i Trajnimit në Menaxhimin e Projekteve për zyrtarët e lartë të përfshirë në zbatimin e investimeve kapitale	2,000 €	Drejtori i Administratës dhe Udhëheqësi i Personelit
Zhvillimi i qasjeve për të punuar në partneritet	Të mbahen dy takime në vit me partnerët që të zhvillohen mundësitë e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit rajonal	Nuk nevojitet kosto.	Drejtori i Administratës

REZULTATI 4C Qeverisje e Mirë dhe bashkëpunim me komunitetin			
Veprimet, projektet dhe programet për të arritur rezultatin	Caku/Matësi	Investimet Kapitale 2016-2018	Personi Përgjegjës
Raporte të rregullta te Kuvendi i Komunes	Raporti o Kryetarit të dorëzohet çdo vit në progresin e planit të integruar	Nuk nevojitet kosto.	Kryetari i Komunës
Freskimi dhe zgjerimi i faqes së internetit të komunës	Freskim sipas nevojës	Nuk nevojitet kosto.	Zyrtar i për informim dhe MAPI.

5. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2016 - 2018

Korniza fiskale komunale apo Korniza e të hyrave komunale përfshinë pjesën e buxhetit komunal nga aspekti i parashikimit të të hyrave të përgjithshme komunale për sigurimin e mjeteve për financimin e shpenzimeve të komunës për periudhën e viteve 2016-2018. Projektionet në kornizën fiskale komunale për vitet 2016-2018, janë të bazuara në përputhshmëri të plotë me kufijtë buxhetor me Qarkoren Buxhetore nr.2016/01 për Komunitat dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018 në nivel të vendit. Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave si nga granti i qeverisë, të hyrave vetanake komunale si dhe shpenzimeve). Për vitin fiskal 2016 parashohim një buxhet prej 2,066,396 € apo një rritje prej 14,552 € ose për 0.71 % më i madh në raport me vitin 2015, kurse për vitin 2017 kemi një buxhet prej 2,089,737 € apo një rritje prej 23,341 € ose për afro 1.13% në raport me vitin 2016, si dhe për vitin 2018 parashohim një buxhet prej 2,115,611 € apo një rritje prej 25,874 € ose për afro 1.24% më i madh në raport me vitin 2017. Analizuar financimin sipas llojeve të granteve qeveritare, në periudhën vijuese 2016-2018, trende të uljes do të kemi në financimin nga **Granti i përgjithshëm (GP)**, pasi që nga shuma prej 865,478 € sa ishte në vitin buxhetor 2015, në vitin e parë buxhetor 2016 do të kemi në dispozicion shumën prej 809,375 € apo një zvogelim prej -56,103 € ose për afër -6.93%.

(Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2016-2018, parashikohet prej 3.61%).

Te Granti Specifik i Arsimit, i cili financim qeveritar ka si kriter kryesor numrin e nxënësve, në vitin 2016 parashikohet të jetë në shumë prej 754,706 € ose një rritje simbolike prej 6.63% apo për vetëm 46,913 € (në vitin 2015 është në shumë prej 707,793 €).

(Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2016-2018, nuk parashikohet rritje, ngel njejtë për tri vite).

Po ashtu, në saje të aplikimit të kritereve të reja si (2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 € për vizitë dhe 3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.89 € për shërbime), kemi trende të njëjta te **Granti Specifik i Shëndetësisë** nga shuma prej 222,325 € sa ishte në vitin 2015, në të njejten shumë ngel edhe në vitin 2016-2018.

(Shkalla mesatare për periudhën 2016-2018, ngelet njejtë).

Ndërsa, **Të hyrat vetanake komunale (THVK)** në vitin pasues 2016, parashikohen të jenë në lartësi prej 280,000 € ose një rritje për 9.26% në raport me vitin 2015 (256,258 €), duke u planifikuar një rritje në masë monetare për 23,742 €.

(Shkalla mesatare e rritjes për periudhën 2016-2018, parashikohet prej 5.69% në vit).

X.x. Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASH-it 2016-2018, në të cilin dokument projektionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetanake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parasë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2015, të parashikuar në KAB Komunale 2016-2018, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2016 dhe projektionet për vitet 2017-2018, përfshijnë të hyrat e planifikuara të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 80,000,000 € per vitin

2016, kurse per vitin 2017 ne shume prej 82,000,000 €, respektivisht per vitin 2018 parashihen të hyra në shumë prej 84,000,000 €.

Tabela – 1. Projektionet e të hyrave vetanake nga Komunat për vitin 2016-2018 në mil. €

Projektimi (mil €)	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Plani 2015	Projek. 2016	Projek. 2017	Projek. 2018
<i>Të hyrat vetanake te komunave</i>	60.00	63.00	67.23	74.24	80.00	82.00	84.00

Tabela -2 Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2016 - 2018

Nr	Burimet e të hyrave	Buxheti 2015	Planifikimi 2016	Parashikimi 2017	Parashikimi 2018
1	Granti i Përgjithshëm	865,478	809,375	822,716	838,590
2	Granti i Arsimit	707,793	754,706	754,706	754,706
3	Granti i Shëndetësisë	222,315	222,315	222,315	222,315
A	Gjithsej financimet qeveritare	1,795,586	1,786,396	1,799,737	1,815,611
4	Të hyrat vetanake	256,258	280,000	290,000	300,000
B	Gjithsej të hyrat vetanake	256,258	280,000	290,000	300,000
A+B	Gjithsej të hyrat komunale	2,051,844	2,066,396	2,089,737	2,115,611

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projektionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet tona të hershme buxhetore për periudhën 2016-2018, Buxheti i komunës do të shënoj trende të rritjes prej vitit në vit, ndërsa vetëm në vitin 2016, në raport me buxhetin aktual 2015, do të shënoj rritje në masë monetare për 14,552 € ose një rritje prej 0.71%.

Në vitin 2017 do të kemi një rritje të lehtë prej vetëm 1.13% ose për 23,341 € në raport me vitin paraprak 2016, si dhe në vitin e fundit 2018, përsëri kemi një rritje të lehte, një rritje e matur prej vetëm 1.24% ose në masë monetare shuma prej 25,874 €, përballë vitit 2017.

Në vitin e parë buxhetor 2016 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve: pjesëmarrja me 86.45% nga të hyrat nga Granti qeveritar dhe 13.55% nga Të Hyrat Vetanake Komunale.

Shikuar sipas viteve dhe strukturës së burimeve të mjeteve, në vazhdim prezantojmë këtë pasqyrë tabelare:

Tabela - 3 Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2016-2018

Nr	Përshkrimi	Buxheti aktual 2015	Plani 2016	Vlerësimi 2017	Vlerësimi 2018
a	B	c	d	e	f
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	2,051,844	2,066,396	2,089,737	2,115,611
1.1	TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE	256,258	280,000	290,000	300,000
1.1.1	Tatimi në prone	93,250	98,500	99,300	100,000
1.1.2	Taksat komunale	124,458	141,300	150,100	156,500
	Licencat dhe lejet	92,608	92,800	93,300	94,000
	Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare	4,350	5,000	5,300	6,000
	Taksat e regjistrimit të mjeteve motorike	14,000	14,000	14,000	14,000
	Lejet për ndërtesa	7,000	22,000	30,000	34,500
	Taksat tjera komunale	6,500	7,500	7,500	8,000
1.1.3	Ngarkesat komunale	34,850	36,500	36,700	39,500
	Ngarkesat rregullatore	17,000	18,000	18,000	20,000
	Të hyrat nga qiraja	6,000	6,000	6,000	6,000
	Bashkë-pagesat për arsim	-	-	-	-
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	5,350	5,500	5,700	6,000
	Ngarkesat tjera komunale (gjobat)	6,500	7,000	7,000	7,500
1.1.4	Të hyrat tjera	3,700	3,700	3,900	4,000
1.2	TRANSFERET QEVERITARE	1,795,586	1,786,396	1,799,737	1,815,611
1.2.1	Granti i Përgjithshëm	865,478	809,375	822,716	838,590
1.2.2	Granti specifik i Arsimit	707,793	754,706	754,706	754,706
1.2.3	Granti specifik për Shëndetësi	222,315	222,315	222,315	222,315

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimit në Pronën e Paluajtshme si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetanake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellëse, kanalizime dhe investime të tjera, që thënë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë iu rikthehen qytetarëve apo tatimpaguesëve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenjes sociale.

Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në Pronë,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit
- Taksat për leje të ndërtimit,
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale,
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike,
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si, certifikatat e lindjes, martesës, shtetësisë etj.),
- Bashkë-pagesat në arsim,
- Bashkë-pagesat në shëndetësi, dhe
- Të hyra tjera (gjobat direkte dhe indirekte).

Përveç të hyrave nga Tatimi në Pronë, kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si: Taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit, taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e pronës komunale, taksa për lejet e ndërtimit, etj.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në Tabelën 8 – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2015 janë të planifikuar në shumë prej 256,258 €, ndërkaq për vitet vijuese 2016-2018, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2016, parashikohen që THVK-të të jenë në masë prej 280,000 € ose një rritje prej 9,26% në raport me 2015, pastaj në vitin 2017 në shumë prej 290,000 ose një rritje në raport me vitin 2016 prej 3.57% dhe në vitin e tretë 2018 shuma prej 300,000 €, ose 3.45% një shtim i të hyrave në krahasim me vitin 2017.

Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2016-2018, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave direkte komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të investimeve kapitale, të cilat do të financohen nga ky burim i të hyrave.

5. KORNIZA E SHPENZIMVE BUXHETORE

5.1. Shpenzimet buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2016-2018, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës. Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore për vitet 2016-2018, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Për vitet 2016-2018, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si: të administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë me mirëqenje sociale. Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2016-2018, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës prej 14.57% në vitin 2016, pastaj për vitin 2017 me një participim prej 15.52% dhe për vitin 2018 me

një ritje prej 16.55%. Në sferën e realizimit të projekteve kapitale 2016-2018, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe Bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike

Tab.4.Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive dhe programeve-Viti 2016

Nen-programi	Programet buxhetore	Kategoritë ekonomike të shpenzimeve për vitin 2016						
		Stafi	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencion e dhe transfere	Shpenzim e kapitale	Totali
16035	Zyra e Kryetarit	7	57,508	20,000		25,000		102,508
16935	Zyra e Kuvendit Komunal	1	55,651	4,000				59,651
16335	Administrata dhe Personeli	17	87,430	38,000	26,000		10,000	161,430
17535	Buxheti dhe Financat	10	49,233	3,000				52,233
18444	Shërbimet Publike dhe Emergjencia	9	53,544	24,000			18,000	95,544
19675	Zyra Komunale për Komunitete	1	4,989	3,000				7,989
47115	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural	5	25,619	3,000		15,104		43,723
48035	Zhvillimi Ekonomik	3	18,353	1,500				19,853
66480	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	49,410	3,000			270,292	322,702
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	34	200,496	26,455	7,216		17,000	251,167
73044	Administrata e shëndetësisë	2	13,502	1,500				15,002
75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	32	186,994	24,955	7,216		17,000	236,165
75671	Shërbimet sociale	3	16,532	3,700	1,000			21,232
920	Arsimi dhe Shkenca	125	747,751	40,345	10,317	11,000	118,951	928,364
92175	Administrata e arsimit	5	28,651	12,500		11,000	118,951	171,102
94020	Arsimi fillor	97	580,828	21,345	8,000			610,173
95220	Arsimi i mesëm	23	138,272	6,500	2,317			147,089
	TOTALI	222	1,366,516	170,000	44,533	51,104	434,243	2,066,396

Struktura në përqindje **66.13%** **8.23%** **2.16%** **2.47%** **21.01%** **100.00%**

Tab.5. Financimi i investimeve kapitale komunale 2016-2018

Komuna - Hani i Elezit

Nr	Programi/përshkrimi	2016 Plani	2017 Vlerësimi	2018 Vlerësimi	Shpenzimet totale 2016-2018
	A	b	c	d	e
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	434,243	457,584	483,458	1,375,285
163	Administrata dhe Personeli	10,000	10,000	-	20,000
16335	Administrata	10,000	10,000	-	20,000
1	Furnizim me inventar për administratë komunale	5,000			5,000
2	Pajisje me TI për administratë komunale	5,000			5,000
3	Mbulimi i parkingut të automjeteve zyrtare	-	10,000		10,000
180	Shërbimet publike dhe emergjenca	18,000	70,000	50,000	113,000
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarrëfikësave	18,000	70,000	50,000	113,000
4	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve të Hanit të Elezit	8,000	10,000	10,000	28,000
5	Fond për emergjencë	10,000	10,000	10,000	30,000
6	Ndërtimi i një stacioni të autobusëve		5,000		5,000
7	Hulumtimi dhe furnizimi i fshatrave me ujë të pijshëm në (Paldenicë, Seçishtë)		10,000	10,000	20,000
8	Shtimi i kapaciteteve të ujit		35,000	20,000	30,000
660	Planifikim urban dhe mjedisi	270,292	307,584	342,458	945,334
66480	Planifikimi urban dhe inspeksioni	270,292	307,584	342,458	945,334
9	Ndërtimi dhe rregullimi i prockës në Lagjen e re	100,000			100,000
10	Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat urbane të Hanit të Elezit (Rruga Dardania, Rrugicat e Rrugës së Lepencit, një pjesë e rrugës Adem Jashari)	20,000			20,000
11	Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat rurale të Hanit të Elezit (Gorancë, Krivenik, Paldenicë, Pusteniç, Laç, Seçishtë)	30,000	40,000	40,000	110,000
12	Mjete të lira për bashkëinvestime	45,000	40,000	90,000	205,000
13	Fond për hartimin e projekteve	5,000	5,000	10,000	20,000
14	Fonde për shpronësim	5,000		10,000	15,000
15	Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonës urbane të Hanit të Elezit	10,000			10,000
16	Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonave rurale të Hanit të Elezit (Rezhancë, Paldenicë, Gorancë)	30,000	20,000	30,000	80,000
17	Hartimi i hartave zonale	5,000			5,000
18	Asfaltimi i rrugës Gorancë - Globoqicë	5,000			5,000
19	Rregullimi i prockës dhe i kanalizimit fekal në fshatin Seçishtë	5,000			5,000

20	Rihapja dhe rregullimi i rrugës nga fshati Dermjak deri te fshati Neqavc	5,000		5,000
21	Gjelbërimi i disa hapësirave publike	3,000		3,000
22	Rregullimi dhe hapja e rrugës nga kroi i fshatit Paldenicë - Ramuk dhe deri te rruga e vneshtëve	2,292		2,292
23	Riparimi i Kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Pustenic (Ndërimi i pllakave të lapidarit)		10,000	10,000
24	Ndërtimi i shtegut të këmbësorëve nga Goranca-Hunel-Rezhancë		20,000	20,000
25	Fasadimi i objekteve publike		9,584	9,584
26	Rregullimi i shtratit të Përroit të Dimcës - faza e dytë		10,000	10,000
27	Instalimi i nxemjes qendrore në shtëpinë e kulturës "Imri Curri"		10,000	10,000
28	Identifikimi dhe sigurimi i pronës për varrezat e qytetit		5,000	5,000
29	Shtrimi me kubëza i rrugës Uji i Thartë – Pustenic		5,000	5,000
30	Asfaltimi i rrugës Ramuk-Kashan		10,000	10,000
31	Rregullimi i rrugës Gorancë-krivenik		10,000	10,000
32	Shtrimi me kubëza betoni i rrugës së varrezave të lagjës së re		10,000	10,000
33	Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza		10,000	10,000
34	Ndërtimi i shtegut për këmbësor dhe biçiklista nga Hani i Elezit - Uji i Thartë		30,000	30,000
35	Ndërtimi kabinave për udhëtar në fshatin Rezhancë, lagjen Hunel dhe fshatin Gorancë		3,000	3,000
36	Rregullimi i kanalizimit fekal nga fshati Gorancë - Rezhancë - Hani i Elezit		20,000	20,000
37	Ndërtimi i rruges nga rruga e Dermjakut deri te lagjja e Ramajve		10,000	10,000
38	Renovimi i shkollës së vjetër në Krivenik		10,000	10,000
39	Rregullimi i burimit të ujit të thartë te Uji i Thartë		10,000	10,000
40	Rihapja e rrugës Pustenic-Laq		10,000	10,000
41	Rihapja e rrugës nga fshati Gorancë deri te lapidary		10,000	10,000
42	Ndërtimi i trotuarit për këmbësor dhe murit mbrojtës të rrugës në fshatin Seqishtë		20,000	20,000
43	Pyllëzimi i zonave të zhveshura-në fshatin Gorancë		7,458	7,458
44	Rregullimi i kanalizimit fekal Krivenik -Seqishtë		20,000	20,000
45	Rihapja e rrugës nga Dermjaku i poshtëm deri te Dermjaku i epërm		20,000	20,000
46	Zgjerimi i rrugëve nga fshati Seqishtë deri në Vorba dhe rruga nga vendi Burim deri në Llokë		10,000	10,000
47	Sigurimi dhe eksproprijimi i pronës për ndërtimin e shkollës fillore në Lagjen e Re		35,000	35,000

48	Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës			40,000	40,000
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	17,000	20,000	21,000	58,000
75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	17,000	20,000	21,000	58,000
49	Rregullimi i rrethojës së AMF-së në fshatin Gorancë	10,000			10,000
50	Paisja e QKMF-së dhe QPS-së me klima	3,000			3,000
51	Paisja me inventar dhe mobilje për QKMF	4,000			4,000
52	Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së		5,000		5,000
53	Ndërtimi i katit të dytë të QKMF-së		15,000		15,000
54	Ndërtimi i një stacioni të ambulancës në fshatin Paldenicë			21,000	21,000
920	Arsimi dhe shkenca	118,951	50,000	70,000	238,951
92175	Administrata	118,951	50,000	70,000	238,951
55	Aneksi i shkollës fillore "Ilaz Thaçi" në Han të Elezit-faza e dytë	103,951			103,951
56	Rregullimi i infrastrukturës shkollore (lyerje, suvatim, izolim)	5,000			5,000
57	Pajisja me inventar për të gjitha shkollat	10,000	10,000		20,000
58	Ndërtimi i çerdhës për fëmijë		5,000		5,000
59	Ndërtimi i fushës sportive me mbulojë të sh.m. "Dardania"		20,000		20,000
60	Ndërtimi i murit mbrojtës të shf. "Ilaz Thaçi" në fsh. Seçishtë		10,000		10,000
61	Pajisja e kabineteve me mjete mesimore dhe laboratorike		5,000	20,000	25,000
62	Ndërtimi i sallave sportive në Paldenicë dhe Gorancë			50,000	50,000

6. MENAXHIMI I PERFORMANCËS NË KOMUNË

Menaxhimi i performances sipas këtij plani do të ngërthenë në vete të gjitha objektivat konkrete të cilat do të bëjnë që niveli i punëve të kryhet në mënyrë sa më adekuate dhe profesionale.

Në këtë kontest do të bëhet edhe trajnimi i të gjithë shërbyesve civil në fushat përkatëse në të cilat do të identifikohen se ata do të kenë nevojë. Trajtimi i parimit të barazisë dhe përparsisë së njëjtë të qytetarëve do të jetë një nga parimet kyçe që do të funksinojë në administratë, gjegjësisht te zyrtarët të cilët kanë drejtpërdrejtë punë zyrtare me qytetarë. Në këtë rrafsh zbatohet kryerja e shërbimeve profesionale duke e rrespektuar palën e barabart para ligjit, trajtimi i të gjithëve njësoj duke e përjashtuar gjininë, përkatësinë fetare, nacionalitetin, gjendjen financiare e kështu me radhë.

Vlerësimi i zyrtarëve në administratën tonë do të jetë vlerësimi meritor, në mënyrë që secili zyrtarë i cili do të vlerësohet të jetë i pranishëm gjatë vlerësimit dhe të jetë në dijeni me punët dhe detyrat me të cilat ka arritur deri te një vlerësim vjetor.

Sigurisht që është thelbësore që performanca jo vetëm të raportohet por të menaxhohet në shumë nivele të ndryshme, duke filluar nga vlerësimet individuale të punëtorëve deri tek drejtorët, që kryetari të marr raporte të rregullta rreth performancës gjatë gjithë vitit. Kjo do t'u mundësojë atyre të kuptojnë problemet dhe fushat me rrezik dhe të japin përgjigje të nivelit të lartë bazuar në informata të freskëta që i merr parasysh rrethanat aktuale.

Procesi i planifikimit vjetor kur bëhet në secilën Drejtori veç e veç , ku do të identifikojë veprimet që do të kontribuojnë në secilin nga katër qëllimet e caktuara në këtë Plan.

Veprimet kyçe të identifikuar në këtë mënyrë atëherë do të formojnë një plan vjetor të ekzekutimit për Planin e Integruar, dhe monitorimi i implementimit të këtyre veprimeve do të theksojë se si progresi po arrihet dhe aty se ku ka nevojë për burime shtesë apo aty ku nevojitet një qasje ndryshe.

Menaxhimi efikas i performancës gjithashtu kërkon një qasje serioze rreth informatave të financave, projekteve, rreziqeve, aspektit organizativ, komenteve të brendshme dhe të klientëve si dhe masat e performancës standarde. Ekzekutimi i Planit të Integruar, Planit Zhvillimor Komunal, i projekteve të mëdha i programeve dhe iniciativave të ndryshme, dhe Plani Financiar Afatmesëm(PFA) të cilat janë shumë të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Diagrami në faqen tjetër ilustron se si ne synojmë të menaxhojmë performancën e ekzekutimit të shërbimeve tona si në projektet kapitale dhe në programet aktuale të të hyrave në mënyrë që vazhdimisht të bëjmë përmirësime në atë se si i përmbushim nevojat e qytetarëve të Hanit të Elezit.

Korniza e Menaxhimit të Performancës për Planifikimin e Integruar

